



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština/Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



P R O C E S V E R B A L I

Mbledhja e Komitetit për Komunitete e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur në datën **27.9.2024**, me fillim në orën **10:35**. Këtë mbledhje e kryesoi kryesuesi i Komitetit për Komunitete, **Bajram Morina**.

Kryesuesi: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! Faleminderit për praninë tuaj! Përshëndetje për përfaqësuesit e KFOR-it, të OSBE-së, shefin e ZKKK-së, Lendrit Qelin, anëtarët e komitetit dhe të gjithë të pranishmit. Ky është takimi i **katërt** për vitin 2024, për takimin e sotëm i kemi këto pika të rendit të ditës:

R E N D I T E

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Informatë nga stacioni policor në Rahovec, rreth gjendjes së sigurisë së komunitetit joshumicë në Komunën e Rahovecit;
3. Informatë nga DKA-ja për regjistrimin e fëmijëve të komunitetit joshumicë për procesin mësimor 2024-2025 - gjendja e regjistrimit, pengesat në regjistrim, braktisja e mësimi;
4. Informatë nga SHL-Kosova për qendrën arsimore pranë ShFMU “Gëzim Hamza - Piktori”;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi: Atëherë, ky është rendi i ditës për sot. Po e vendosim në votim si të tillë. Kush është “për”?... Me shumicë unanime aprovohet rendi i ditës.

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: A ka dikush ndonjë gjë rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Konstatohet që unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës.

2. Informatë nga stacioni policor në Rahovec, rreth gjendjes së sigurisë së komunitetit joshumicë në Komunën e Rahovecit:

Kryesuesi: Sekretaria e Kuvendit është kujdesur që t’i lajmërojë të gjithë për mbledhjen e sotme, por, zyrtarët nga policia mungojnë për shkak të obligimeve të tyre. Besojmë që kjo pikë do të shqyrtohet në mbledhjet e radhës.

Skender Hamza: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Sekretaria e Kuvendit çdo herë e kryen punën e vet, por, paraprakisht është mirë që ju si komitet të merreni vesh me stacionin e policisë dhe me DKA-në për datat e lira të tyre dhe të gjendet një mes, që në mbledhjet e radhës mos të mungojnë.

3. Informatë nga DKA-ja për regjistrimin e fëmijëve të komunitetit joshumicë për procesin mësimor 2024-2025 - gjendja e regjistrimit, pengesat në regjistrim, braktisja e mësimi:

Kryesuesi: Gjithashtu edhe pika e tretë do të diskutohet në mbledhjen e radhës, sepse edhe drejtori i Arsimit mungon për shkak të agjendës së ngjeshur.

4. Informatë nga SHL-Kosova për qendrën arsimore pranë ShFMU “Gëzim Hamza - Piktori”:

Vjollca Gurgule: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Jemi duke operuar me projektin “Advancing together”, gjithashtu është sfidë e madhe sepse mungon vetëdijësimi i prindërve për t’i dërguar fëmijët e tyre në shkollë. Kemi pasur takime me DKA-në, me drejtorin e shkollës dhe me ZKK-në. Janë mbajtur tri takime për të diskutuar funksionalizimin e qendrës mësimore dhe bashkëpunimin gjatë implementimit të projektit. Takim me mësimdhënësit dhe drejtorin e shkollës. Në muajin prill është mbajtur një takim për gjendjen e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe për të marrë listat e nxënësve, me të cilët do të punojë stafi i qendrës. Kemi bërë vizita në familjet e komuniteteve. Janë bërë vizita të shumta në familjet e komuniteteve për t’i informuar për qendrën mësimore dhe programin që ofron. Prindërit kanë shprehur miratimin e tyre për vijimin e programit nga fëmijët e tyre. Mësimi shtesë në qendrën mësimore: mësimi shtesë ka filluar rregullisht me fokus në matematikë dhe në gjuhën shqipe, duke përdorur metoda atraktive për të përmirësuar kuptueshmërinë dhe argëtimin e nxënësve. Aktivitete sportive: në muajin maj është mbajtur një turnir në futboll të vogël për vajza dhe për djem, me pjesëmarrje të nxënësve të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian dhe shqiptar. Ky aktivitet ka promovuar integritetin ndëretnik dhe vlera pozitive, si puna në grup dhe respekt. Mospërputhja e numrit të nxënësve: numri i nxënësve në qendër nuk përputhej me listat zyrtare. Pas vizitave në familje, është identifikuar një vijueshmëri e parregullt dhe braktisje e shkollës nga nxënësit e komuniteteve. Takim urgjent me drejtorin dhe me pedagogen e shkollës: pas identifikimit të problemeve, u mbajt një takim urgjent me drejtorin dhe me pedagogen e shkollës. Situata u konfirmua dhe u bë një analizë e saktë nga shkolla, duke marrë një listë me nxënës që kishin braktisur shkollën dhe ata me mungesa të mëdha. Takim me prindërit, me ZKK-në dhe me shkollën: u realizua një takim ku u diskutuan problematikat dhe arsyet e braktisjes së mësimin. Disa nxënës shprehën interesim për t’u rikthyer në shkollë. Takim me DKA-në dhe me ZKK-në: u diskutua për rastet e braktisjes dhe për nxënësit që dëshironin të riktheheshin në shkollë. U vendos që rikthimi të bëhet në shtator, në fillimin e vitit të ri shkollor. Pas ndërhyrjeve, numri i braktisjeve dhe i mungesave të shumta ka filluar të zvogëlohet. Nxënësit janë më të përgatitur për mësimin e rregullt dhe vijnë në shkollë rregullisht. Shumë nxënës ndiqnin me rregull mësimin në qendrën mësimore, ndërsa atë në shkollë jo. Falë bashkëpunimit me prindërit dhe me mësimdhënësit, ky problem është zgjidhur!

5. Të ndryshme:

Doruntina Sopjani: Përshëndetje për të gjithë! Më herët e kam paraqitur një kërkesë për rregullimin e urës në lagjen “Berisha” në fshatin Dobidol. Lagja është e banuar nga minoritete. Kërkoj që ta vizitoni, sepse gjendja është në gjendje jo të mirë. Aty afër ka ura të improvizuara me drunj dhe në momentin kur ka reshje, urat nuk janë të qëndrueshme dhe shfaqin rrezik.

Lendrit Qeli: Faleminderit, kryesues! Së bashku me organizatën “IOM”, besoj që do ta kemi mundësinë të bëjmë një zgjidhje urgjente në atë pjesë.

Merisa Sharku: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Një pyetje rreth qendrës arsimore: çfarë është bërë për fëmijët e fshatrave në këtë aspekt?

Vjollca Gurgule: Jemi munduar të punojmë edhe në fshat, përveç qytetit, por kapacitetet tona janë të vogla dhe për këtë arsye jemi duke vazhduar të punojmë me këtë qendër vetëm në qytet.


Merisa Sharku: Sa është mbështetja e Komunës së Rahovecit për këtë çështje dhe sa është angazhimi i tyre për të thithur fonde?

Lendrit Qeli: Kanë qenë 4 projekte. Sa i përket mbështetjes në qendër, nuk e kemi një zot shtëpie dhe nuk kemi përkrahje të mjaftueshme. Nga buxheti i Komunës së Rahovecit i kemi 20.000€ dhe këto janë vetëm për investime kapitale. Niveli qendror duhet ta ndryshojë këtë rregullore, qendra të licencohet dhe të ketë të drejtë për aplikim për të thithur fonde të ndryshme. Gatishmëria e kryetarit të Komunës për participim asnjëherë nuk mungon. Do të kërkojmë që për çështjen e komuniteteve të mos kemi kufizim, që kodin buxhetor ta kemi vetëm për investime kapitale, por edhe për subvencione.

Kryesuesi: Faleminderit, z. Lendrit! Atëherë, nëse nuk ka dikush tjetër diçka për të shtuar. Këtu e mbyllim takimin e katërt me radhë. Faleminderit për kontributin, shihemi!


Mbledhja përfundoi: 11:10

Procesmbajtësi:



Albion Krasniqi

Kryesuesi i mbledhjes:



Bajram Morina

